

Leutrimi i vogël flinte në krevatin e tij më **5.06.1998**, kur nga ora 11:00, në dhomën e tij filluan të binin ciflat e predhës, e cila e ka qëlluar shtëpinë e kushëririt të prindërve të tij, që gjendej përkrah shtëpisë së familjes Agaj në **Gramaçel/Gramočelj**. Një nga ciflat e predhës e ka qëlluar Leutrimin në kokë. Granata ishte shkrepur nga shpati i quajtur *Sukë/Suka*, nga forcat serbe të cilat bombardonin fshatin. Leutrimi ishte në gjendje gjysmë të pavetëdijshme dhe prindërit e çuan urgjentisht në spitalin e UÇK-së në Irzniq/Rznić. Por, pas një ore, Leutrimi dha shpirt. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur atë në varrezat në Gramaçel/Gramočelj. Në pranverë të vitit 2002, familja i ka riarrosur mbetjet mortore të Leutrimin në Varrezat e Dëshmorëve të Lufës, në Gramaçel/Gramočelj.

Burimet: deklarata S.A, FDH-19231; KMDLNI, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 201, FDH-23816.

Brahim (Arif) Lokaj

(28.03.1916, shqiptar nga Prilepi/Prilep, komuna e Deçanit/Deçani, gjeometër, dy fëmijë)

Shtëpia e Brahimin ishte në afërsi të rrugës magjistrale Deçan/Deçane - Gjakovë/Đakovica. Gjatë luftës, në afërsi të shtëpisë së tij ishte një bunker i UÇK-së. Në fund të vitit 1998 dhe për shkaqe sigurie, familja e Brahimin ka lëvizur në thellësi të fshatit, përderisa Brahimin ka mbetur në shtëpi. Shkonte çdo ditë te familja për drekë dhe kthehej në shtëpi vonë në mbrëmje. Herën e fundit erdhi për drekë më **5.06.1998**. Atë ditë avionët e forcave serbe e kanë bombarduar fshatin. Po atë ditë, familja ka dëgjuar në lajmet e BBC-së se në udhëkryqin e fshatit **Prilep**, atë ditë ishte vrarë një plak. Menjëherë kuptuan se bëhej fjalë për Brahimin. Deri në fund të luftës, familja nuk kishte kurrfarë njohurish se si ka ndodhur vrasja e tij dhe as çfarë ka ndodhur me trupin e tij. Pas përfundimit të luftës, familjarët kanë mësuar nga mediat se trupi i Brahimin ishte varrosur në varrezat e Gjakovës/Đakovica. Vëllai i Brahimin me disa të afërm kanë shkuar në Gjakovë/Đakovica dhe e kanë zhvarrosur varrezën e

përmendur [8.09.1999]. E identifikuan Brahimin në bazë të rrobave dhe këpucëve. Në xhemperin e tij shiheshin mbi 30 vrima nga plumbat. Brahimin e riarrosën po atë ditë në varrezat e Prilepit/Prilep.

Burimi: deklarata G.L, FDH-19242.

Beqir (Haxhi) Qufaj

(14.06.1977, shqiptar nga Prilepi/Prilep, komuna e Deçanit/Deçani, pjesëtar i UÇK-së)

Beqiri ka qenë pjesëtar i UÇK-së dhe për detyrë e kishte observimin e terrenit dhe bartjen e armatimeve nga Shqipëria. Në datën **5.06.1998**, forcat serbe e sulmuan **Prilepin/Prilep** nga ajri. Beqiri u plagos rëndë gjatë këtij sulmi. Ka dhënë shpirt po atë ditë në spitalin e UÇK-së në Irzniq/Rznić. E kanë varrosur në varrezat e Dashinocit/Dašinovac më 6.06.1998. Mbjetjet mortore të Beqirit janë riarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Prilep më 3.09.1999.

Burimet: J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Gazmend (Selman) Lokaj

(7.09.1974, shqiptar nga Prilepi/Prilep, komuna e Deçanit/Deçani, pjesëtar i UÇK-së)

Gazmendi i ka ndërprerë studimet në Fakultetin Juridik pasi e kanë ftuar në shërbimin e rregullt ushtarak në ushtrinë e ish Jugosllavisë. Në datën 23.04.1998, ai me të vëllain Blerimin [të shikohet regjistrimi] aderuan në UÇK. Në fund të muajit prill të vitit 1998, ai u plagos gjatë luftimeve me forcat serbe në fshatin Voksh/Vokša. U kthye në detyrë menjëherë pas rikuperimit. Gazmendi ka rënë gjatë luftimeve me forcat serbe në fshatin **Prilep** më **5.06.1998**. Sot, ai prehet në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Prilep.

Burimet: J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Osmon (Brahim) Hadërgjonaj

(1898, shqiptar nga Pobrja/Pobrde, komuna e Deçanit/Deçani, bujk)

Forcat serbe e kanë nisur sulmin mbi fshatin